



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 911/4 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

**V E N D I M**

Nr. 60 datë 05.12.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË TË  
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA NGA ORGANET E  
NGARKUARA NGA LIGJI, GJATË PROCESIT TË ECURISË DISIPLINORE, NË  
INSTITUCIONIN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË E  
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *Ilir Kaimi*, në institucionin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar,

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 911 prot., datë 10.11.2025, të paraqitur nga nëpunësi *Ilir Kaimi*, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Vlerësimit, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, është njohur me pretendimet e nëpunësit për parregullsi të pretenduara në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së ecurisë disiplinore të nisur në ngarkim të tij, në

përfundim të së cilës është dhënë masa disiplinore “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë gjashtëmuajore”, e parashikuar nga neni 57, pika 3, germa a), e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe dokumentacionit të administruar bashkëlidhur, nëpunësi Ilir Kaimi, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Vlerësimit, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, ngre pretendime për shkelje ligjore të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore në ngarkim të tij, në përfundim të së cilës, Komisioni Disiplinor ka marrë vendim nr. 219, datë 7.7.2025, për dhënien e masës disiplinore “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë gjashtëmuajore”, në kushtet kur, nëpunësi ka qënë me raport mjekësor.

Sa më lart, nëpunësi pretendon se, akti për dhënien e masës disiplinore është nxjerrë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit dhe në shkelje të të drejtave themelore të nëpunësit civil, duke mos marrë parasysh gjendjen shëndetësore të konstatuar nga organet mjekësore kompetente.

Në këto kushte, nëpunësi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke vlerësuar se lindin dyshime të arsyeshme në lidhje me parregullsi në drejtim të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me shkresën nr. 911/1 prot., datë 24.2.2025, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të regjistruar me nr. 911 prot., datë 8.11.2025*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të procedurës disiplinore, duke kërkuar njëkohësisht edhe dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 7101 prot., datë 25.11.2025, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 911/2 prot., datë 26.11.2025, ka dërguar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative të kryera gjatë këtij procedimi disiplinor, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, rezulton se:

Nëpunësi Ilir Kaimi, me aktin nr. 403, datë 1.11.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, është emëruar nëpunës civil në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Vlerësimit, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, pranë AKSIK.

Sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se, në protokollin e institucionit, është depozituar Vendimi nr. 654 (80-2025-664), datë 5.3.2025, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë të paditur AKSIK, i cili është shqyrtuar në takimin e datës 8.4.2025, të mbajtur midis Drejtorit të Përgjithshëm, me Sektorin e Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, ku bën pjesë edhe punonjësi Ilir Kaimi. Në përmbajtjen e këtij vendimi gjyqësor, është evidentuar se: “*Pala e paditur, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, nuk është paraqitur në gjykim dhe nuk i ka paraqitur gjykatës akte provuese apo qëndrim me shkrim, në lidhje me kërkesë–padinë objekt gjykimi.*”

Në këto rrethana, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është kërkuar shpjegim lidhur me arsyet për të cilat nëpunësi civil Ilir Kaimi, nuk ka marrë pjesë në seancën gjyqësore të datës 5.3.2025, në cilësinë e Specialistit, me autorizim të posaçëm, i cili përfaqëson institucionin dhe kryen çdo veprim procedural gjatë shqyrtimit gjyqësor apo administrativ të çështjeve ku institucioni është palë, si dhe administron një kopje të praktikës dokumentare të këtyre çështjeve.

Në lidhje me këtë fakt, nëpunësi civil, përmes një Memo-je informuese, ka pohuar se ka munguar për arsye familjare. Pas njohjes me përmbajtjen e Memo-s, Drejtori i Përgjithshëm ka bërë shënimin: “*Të evidentohet dhe të mbahet përgjegjësi për mosparaqitjen nga nëpunësi i ngarkuar, referuar kuadrit ligjor në fuqi.*”

Në vijim, eprori direkt i nëpunësit, pasi është njohur me aktet e administruara në lidhje me këtë proces gjyqësor, ka konstatuar se, nëpunësi Ilir Kaimi nuk ka paraqitur provat dhe nuk ka ndjekur seancat pasuese gjyqësore, duke e konsideruar këtë fakt, si: mospërbushje detyre nga ana e nëpunësit civil Ilir Kaimi.

Më tej, eprori direkt, me anë të relacionit të datës 8.4.2025, mbështetur në nenin 18 dhe pikën 1, të nenit 36, të Rregullores së Brendshme të DSIK, në pikën 1, të nenit 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në pikën 9, të kreut II, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, ka bërë klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, në kategorinë shkelje të rënda.

Pas klasifikimit të shkeljes, eprori direkt, bazuar në pikën 10, të kreut II, të VKM-së nr.115, datë 5.3.2014, i ka kërkuar Komisionit Disiplinor të fillojë ecurinë disiplinore.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bazuar në nenet 57 deri 59, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, me anë të Urdhrit nr. 113, datë 16.4.2025, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecuresë disiplinore ndaj nëpunësit civil Ilir Kaimi”, Drejtori i Përgjithshëm i AKSIK, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecuresë disiplinore ndaj nëpunësit Ilir Kaimi, me përbërje si më poshtë:

- Z. Enton Sadiku – Kryetar i Komisionit Disiplinor;
- Z. Mark Ndreca – Anëtar;
- Zj. Klarita Bejko – Anëtare;
- Z. Ervin Brari – Anëtar;
- Z. Albi Mato – Anëtar (përfaqësues i DAP-it).

Referuar akteve të emërimit të nëpunësve të evidentuar më lart, rezulton se, përbërja e këtij organi është në përputhje me kërkesat e pikës 2, kreu 1, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, pasi përfaqësohen të gjitha rolet që parashikohen në këtë akt nënligjor.

Në vijim, me shkresën nr. 2391 prot., datë 29.4.2025, “Njoftim për fillimin e ecuresë disiplinore dhe mbledhjen e Komisionit Disiplinor ndaj nëpunësit Ilir Kaimi”, të Komisionit të Disiplinës, është njoftuar nëpunësi për fillimin e ecuresë disiplinore, me motivacionin: “shkelje të rënda”, të parashikuara në nenin 57, pika 3, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar dhe caktimin e seancës dëgjimore në datën 9.5.2025, ora 10:00.

Referuar procedurës së ndjekur, rezulton se janë respektuar afatet dhe kërkesat e parashikuara në VKM-në nr. 115, datë 5.3.2014, si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 21.1.2025, të DAP.

Më tej, Komisioni Disiplinor është mbledhur në datën e caktuar, dokumentuar në procesverbalin nr. 139 prot., datë 9.5.2025, ku kanë qënë të pranishëm të gjithë anëtarët e KD, si dhe nëpunësi civil Ilir Kaimi, i shoqëruar nga avokati i tij, z. Taulant Asllani, i cili ka paraqitur kërkesat paraprake dhe prapësimet përkatëse, të cilat janë plotësuar edhe me shkresat nr. 2563 prot., datë 19.5.2025; nr. 2930 prot., datë 27.5.2025; nr. 2998 prot., datë 4.6.2025 dhe nr. 3493 prot., datë 27.6.2025, për paraqitjen e provave të reja.

Në vijim të zhvillimit të kësaj procedure disiplinore, sipas procesverbalit nr. 2188 prot., datë 7.7.2025, Komisioni Disiplinor është mbledhur në seancën e radhës, ndërkohë që nëpunësi nuk është paraqitur, pa pasur arsye të përligjur, edhe pse ka marrë njoftim, fakt ky i provuar nga “Libri i dorëzimit të korrespondencës”, në AKSIK.

Në përputhje me kërkesat e pikës 4, germa c), kreu II, të Udhëzimit nr. 1, datë 21.1.2025, të DAP-it, Komisioni Disiplinor ka hetuar shkaqet e mosparaqitjes së nëpunësit në seancat dëgjimore, duke arritur në përfundimin se, nuk ka pasur arsye të përligjura të mbështetura në dokumentacion justifikues.

Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 219, datë 7.7.2025, ka vlerësuar se, mospërfaqësimi i institucionit në gjykim në mënyrë të pajustificuar, nga ana e nëpunësit Ilir Kaimi, klasifikohet si: *shkelje e rëndë disiplinore*, “*mospërmbushje e detyrave*” e parashikuar në germën a), pika 3, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Për këto arsye, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë 6 muaj*”, në ngarkim të nëpunësit Ilir Kaimi.

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit rezulton se, nga pikëpamja procedurale, gjatë zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore janë respektuar të gjitha kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë institutin e disiplinës në shërbimin civil, që nga konstatimi i shkeljes disiplinore; klasifikimi i saj nga eprori direkt; vënia në dijeni e nëpunësit; respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur; administrimi i provave; deri tek marrja e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor.

#### **Për këtë arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së nisur kryesisht në bazë të informacionit të rregjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 911 prot., datë 10.11.2025, të paraqitur nga nëpunësi Ilir Kaimi, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në përfundim të së cilit është dhënë masa disiplinore *Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë gjashtëmuajore*, në ngarkim të tij, në kushtet kur në veprimet e kryera nga organi kompetent eprori direkt dhe Komisioni i Disiplinës, nuk konstatohen elementë që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe nëpunësi *Ilir Kaimi*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**